



Funded by
the European Union

D RACAK PËR BARTËSIT E TË DREJTAVE

IPRproject
Intellectual Property Rights Project

A Project Implemented By:



HYRJE

TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFERTA NË KOSOVË (ZDA)

Zyra e të Drejtave të Autorit dhe të Drejtave të Përafërta (ZDA), si organ administrativ, me Drejtorin në krye të saj, themeluar dhe që funksionon nën mbikëqyrjen e Ministrisë të Kulturës, do të ketë detyrat e mëposhtme:

a. zhvillimi dhe zbatimi i strategjive dhe politikave adekuate për mbrojtjen, ushtrimin dhe zbatimin e të drejtës së autorit, të drejtave të përafërta dhe të drejtave të tjera në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, legjislacionin vendor dhe interesat gjegjësisht shtetërore të Republikës së Kosovës;

b. mbledhja e informatave të nevojshme, kryerja e studimeve dhe konsultimi me organet qeveritare, institucionet, si dhe me përfaqësuesit e bartësve të interesuar të të drejtave dhe përdoruesve;

c. dorëzimi tek Qeveria dhe/ose organet tjera qeveritare i propozimeve ku paraqiten masat e nev-

TË AU

ojshme për zbatimin e strategjisë dhe politikave të përmendura më lart;

d. përgatitja e projektligjeve dhe rregulloreve në lidhje me mbrojtjen, ushtrimin dhe zbatimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta me të;

e. përfaqësimi i Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare dhe rajonale që merren me të drejtat e autorit, të drejtat e përafërta dhe të drejtat e tjera të mbrojtura me këtë ligj;

f. vendosja dhe mirëmbajtjen e bashkëpunimit me dobi të ndërsjellë me zyrat qeveritare, agjencitë dhe institucionet kërkimore dhe organizatat tjera të vendeve të tjera që merren me të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta me to, në pajtim me politikën ndërinstitucionale të Republikës së Kosovës;

g. në bashkëpunim me autoritetet kompetente gjyqësore, adminis-

trative dhe doganore - dhe sipas nevojës, inicimi i procedurave për ekzekutim - pjesëmarrje aktive në luftën kundër shkeljeve të të drejtave, e në veçanti, piraterisë;

h. akreditimi dhe mbikëqyrja e aktiviteteve të organizatave të kolektive të menaxhimit;

i. promovimi i vetëdijesimit të organeve qeveritare, institucioneve gjyqësore, administrative dhe institucioneve të tjera, bartësve të të drejtave dhe përdoruesve, si dhe publikut të gjerë, në lidhje me rëndësinë dhe aspektet politike, ligjore dhe praktike të mbrojtjes, ushtrimit dhe zbatimit të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, përmes përgatitjes dhe shpërndarjes së materialeve informuese, organizimit të fushatave vetëdijesuese dhe mirëmbajtjes së raporteve aktive me shtypin dhe mediat.

•

DREJTAT E
AUTORIT DHE TË

Brenda këtij konteksti, një nga detyrat më të rëndësishme të ZDA-së është të inkurajojë e të mbështesë krijimtarinë në fushat e kulturës dhe shkencës përmes mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta. Për këtë qëllim, vetëdijesimi publik ka rëndësi parësore, pasi njerëzit duhet të kuptojnë se a) e drejta e autorit është një lloj prone dhe si e tillë duhet të respektohet dhe mbrohet, si dhe b) rëndësia e të drejtës së autorit është mjet thelbësor që promovon kulturën dhe krijimtarinë, në dobi të shoqërisë dhe ekonomisë së vendit.

Që nga qershori i vitit 2011, ZDA-ja ka ecur mirë në kontributin e saj në zhvillimin e regjimit të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta deri në nivel të standardeve moderne ndërkombëtare, si dhe ofron edhe udhëzime dhe edukim për publikun.

Më konkretisht, ZDA-ja ka ndërmarrë veprime në:

Rritjen e avancimit në kornizën legjislative, posaçërisht në hartimin e ligjeve dhe rregulloreve të reja për të zbatuar legjislacionin vendor, si dhe për të arritur harmonizim të plotë me legjislacionin e BE-së;

Organizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve edukative për zyrtarët shtetërorë që kanë kompetenca në fushën e të Drejtave të Autorit;

Organizimi i aktiviteteve të ndryshme si konferenca për media; seminare; fushata vetëdijesimi, përfshirë ato në internet, ashtu që të rritet vetëdija dhe të inkurajohet krijimtaria, si dhe respektimi i të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta me to.

Licencimin e dy shoqatave kolektive të menaxhimit kolektiv, APIK në fushën e muzikës dhe VAPIK në fushën e veprave audiovizive, si dhe punën me shoqatat e licencuara dhe përdoruesit në përcaktimin e tarifave të përgjithshme për përdorimin e lëndës së mbrojtur nga e drejta e autorit në fushën e transmetimeve dhe ritransmetimeve.

Koordinimin e veprimeve kundër piraterisë fizike dhe digjitale, të ndërmarra nga Task Forca kundër Piraterisë, ku si pasojë e këtij, Kosova më nuk ngec prapa vendeve të rajonit në luftimin e piraterisë fizike.

Punën e afërt me institucionet përgjegjëse kombëtare, përkatësisht anëtarët e Task Forcës dhe Këshillin Kombëtar të Pronës Intelektuale me qëllim forcimin e bashkëpunimit;

Bashkëpunimin me zyrat simotra në rajon dhe më gjerë. Vlen të përmendet bashkëpunimi i shkëlqyeshëm me Zyrën Shqiptare të të Drejtave të Autorit.

Vendosjen e raporteve të shkëlqyera me përfaqësuesit e Zyrës së BE-së në Kosovë dhe projektet e mbështetura nga BE-ja, për përforcimin e sistemit të DPI-ve në Kosovë.

Ky Doracak është përgatitur dhe botuar nga ZDA-ja. Ky prezanton një pasqyrë të së drejtës, funksionalitetin dhe qëllimin e saj, analizon të drejtat që i jepen bartësit të të drejtave, lëndën e mbrojtjes, si dhe çështjet që lidhen me menaxhimin dhe shfrytëzimin kolektiv, derisa po ashtu shpjegon zbatimin. Qëllimi i Doracakut është t'u përgjigjet pyetjeve themelore ligjore që lidhen me këtë fushë, si dhe të qartësojë para bartësve të të drejtave nocionet dhe konceptet që lidhen me çështjet e të Drejtave të Autorit dhe atyre të përafërta.

PËRKUFIZIMI NË LIGJIN E PRONËSISË INTELEKTUALE

ÇFARË ËSHTË PRONA INTELEKTUALE?


Krijimet e mendjes njerëzore mbrohen nga Ligji për Pronësinë Intelektuale (IP). Karakteristika më e rëndësishme e Ligjit për PI është se ai u jep pushtet monopolistik bartësve të së drejtës; kjo do të thotë që bartësit e të drejtave kanë të drejtë të ndalojnë çdo palë të tretë nga përdorimi dhe shfrytëzimi i krijimit të mbrojtur të mendjes si dhe të vendosin nëse dhe në cilat rrethana do të autorizojnë përdorimin dhe shfrytëzimin e veprës.

Njerëzit shpesh ngatërrojnë nocionet e ligjit të PI-së me Ligjin për të Drejtat e Autorit. Në fakt, PI është termi i përgjithshëm juridik që përdoret në Ligj për të përshkruar Ligjin për të Drejtën e Autorit dhe Ligjin për Pronësinë Industriale. E drejta e autorit i referohet krijimeve artistike dhe letrare, ndërsa prona industriale përfshin markat tregtare, patentat të cilat jepen për shpikje, dizajnet industriale (dizajne), emrat e domeneve, treguesit gjeografikë dhe Emërtimet e mbrojtura të orig-

jinës (PDO), topografi të produkteve gjysmëpërçuese dhe varietete të reja të bimëve. Sekretet komerciale dhe industriale, njohuritë teknike dhe konkurrenca e padrejtë konsiderohen gjithashtu të drejta “satelit” të të drejtave të pronësisë intelektuale, në kuptimin që edhe pse nuk janë pjesë e ligjit për PI, lënda e tyre mbrohet për arsye të ngjashme.

Të drejtat e PI-së (DPI) janë të drejtat që jepen nga ligjvënësi për krijuesit e veprave, shpikjeve, markave tregtare, etj., për t'i mundësuar atyre që të shfrytëzojnë ekskluzivisht krijimet e tyre (p.sh. Duke i ndaluar palëve të treta të paautorizuara përdorimin e tillë). DPI-të, për shkak të natyrës së tyre absolute dhe ekskluzive, janë shumë të ngjashme me pronësinë. Karakteristika e tyre kryesore dhe dallimi qenësor nga pronësia është se të drejtat e pronës intelektuale (DPI) janë jomateriale, e kjo është arsyeja që duhet të trajtohen ndryshe nga prona e prekshme.

Skematikisht, e drejta e pronësisë intelektuale mund të paraqitet si më poshtë:



Në këtë Doracak do të përqendrohemi dhe analizojmë vetëm të Drejtat e Autorit.

TË KUPTOJMË TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA

E DREJTA E AUTORIT

ÇFARË ËSHTË E DREJTA E AUTORIT?

E drejta e autorit është mbrojtja që i bëhet me ligj autorëve, duke i dhënë të drejtën të kontrollojnë punën e tyre krijuese. Ligji për të drejtën e autorit bazohet në bindjen se autorët e veprave krijuese meritojnë kompensim të arsyeshëm dhe të drejtën për të kontrolluar përdorimin e krijimeve të tyre.

PSE NA DUHEN TË DREJTAT E AUTORIT? - ARSYESHMËRIA E LIGJIT

PËR TË DREJTËN E AUTORIT

E drejta e autorit promovon krijimin e veprave në fushën e letërsisë, artit dhe shkencës, duke u dhënë autorëve të drejta absolute dhe ekskluzive mbi veprat e tyre për një kohë të kufizuar. Por pse është kaq e rëndësishme t'i atribuohen të drejtat ekonomike dhe morale autorit? Përgjigja është se autori duhet të shpërblehet për punën e tij/saj dhe njerëzit duan që autori të vazhdojë veprimtarinë e tij krijuese. Në planin afatgjatë, është kultura ajo që përforcohet e në fund të fundit, edhe qytetarët e vendit. Në të njëjtën kohë, e drejta e autorit inkurajon investimet në krijime artistike.

Në të njëjtën kohë, e drejta e autorit ka kufij që garantojnë që publiku do të ketë qasje në vepra dhe të përfitojë prej tyre.

Sot, për shkak të faktit se e drejta e autorit vlen për vepra që ndikojnë në inovacion, konsiderohet se natyra ekskluzive dhe absolute e të drejtës së autorit inkurajon personat fizikë dhe juridikë të investojnë në krijimin e veprave inovative. Në të njëjtën kohë, materiali i të drejtës së autorit, duke qenë e drejtë pronësore, është pasuri e pronarit.

DISA INFORMATA HISTORIKE INTERESANTE

Historikisht, Ligji për të Drejtat e Autorit është i lidhur me përparimin teknologjik. Në fakt, teknologjia ka kontribuar në krijimin e Ligjit për të Drejtat e Autorit. Përveç kësaj, në teorinë e Ligjit për të Drejtat e Autorit, shpikja e tipografisë konsiderohet të jetë moment historik i fushës, pasi çon në njohjen e të ashtuquajturave "privilegje" që njiheshin nga autoritetet shtetërore fillimisht për shtypshkronjat dhe botuesit - librashitësit, e më vonë edhe për autorët. Sidoqoftë, përveç të qenit mekanizëm mbrojtës i interesave profesionalë të botuesve, privilegjet ishin kryesisht mekanizëm censurimi.

E gjithë rryma kulturore dhe filozofike e kësaj periudhe, së bashku me arritjet teknologjike, çuan në krijimin e Ligjit për të Drejtat e Autorit. Akti për të Drejtat e Autorit i vitit 1709 i Mbretërisë së Bashkuar ishte ligji i parë që fut të drejtën e autorit në sistemin juridik. Ky ligj u dha autorëve të drejtën ekskluzive të botojnë librat e tyre për 21 ose 14 vjet, varësisht nëse librat ishin botuar tashmë apo jo. Megjithatë, legjislacioni i parë i plotë lindi në Francë, menjëherë pas Revolucionit Francez. Ligji i vitit 1791 krijoi të drejtën ekskluzive të krijuesve për interpretimin e veprave të tyre teatrale dhe muzikore, ndërsa Ligji i vitit 1793 krijoi të drejtën ekskluzive të riprodhimit.

VEPRA

ÇFARË ËSHTË VEPRA?

E drejta e autorit mbron veprat e shkencës, në fushën e letërsisë, artit ose shkencës, të krijuara nga një autor, një person fizik, që gjendet në origjinë të veprës. Veprat e mbrojtura renditen në ligj si më poshtë:

(a) veprat letrare (të shprehura me shkrim ose me gojë, përfshirë programet kompjuterike);

(b) vepra dramatike dhe dramatike-muzikore,

(c) vepra muzikore, me ose pa tekst;

(d) vepra koreografike dhe argëtuese në shfaqje pa zë;

(e) vepra kinematografike dhe vepra të tjera audiovizive;

(f) veprat e arteve të bukura (piktura, vizatime, skulptura, etj.);

(g) veprat e arkitekturës;

(h) punimet fotografike, përfshirë punimet e shprehura nga çdo proces analog me fotografinë;

(i) veprat e artit aplikativ;

(j) harta, plane, skica dhe punime tre-dimensionale në lidhje me gjeografinë, topografinë, arkitekturën dhe shkencat e tjera.

Në anën tjetër, këto të tjerat nuk mbrohen me të drejtë autori:

(a) idetë, procedurat, metodat e operimit apo konceptet matematikore si të tilla (por vetëm në shprehjet e tyre origjinale);

(b) shprehje të folklorit;

(c) lajmet e ditës, faktet e pastra dhe të dhënat si të tilla (por vetëm për prezantimin e tyre origjinal); informata të ndryshme që kanë karakterin e raporteve të zakonshme mediale mund të riprodhohen vetëm pasi të kenë kaluar të paktën dymbëdhjetë (12) orë nga publikimi i tyre.

CILAT JANË KUSHTET PËR MBROJTJEN E NJË VEPRE?

Për të mbrojtur një vepër, ajo duhet të jetë origjinale, domethënë duhet të ketë veti statistikisht unike, si dhe duhet të pasqyrojë personalitetin e krijuesit të saj. Originaliteti qëndron në shprehjen e personalitetit të autorit, lidhjen intime midis autorit dhe veprës së tij, shenjën personale; vepra duhet të paraqesë një nivel të caktuar të krijimtarisë.

Idetë e thjeshta nuk mbrohen; mbrohen vetëm veprat që janë formuar dhe eksternalizuar (ndarë nga mendja e autorit), me kushtin që të jenë origjinale. Originaliteti nuk duhet ngatërruar me risinë; një piktor mund të pikturojë të njëjtin peizazh të pikturuar nga një piktor tjetër, por ajo që ka rëndësi është të shprehet, duke vënë në atë vepër shenjën e tij/saj personale.

Ajo që është interesante të vihet në dukje është se një krijim që përmbush kriteret e mësipërme mbrohet pavarësisht nga forma që ka marrë ose kohëzgjatja e tij në kohë. Kjo do të thotë që një skulpturë në akull mund të mbrohet nga Ligji për të Drejtën e Autorit, për aq kohë sa përmbush nocionin e origjinalitetit. Mjafton që krijimi origjinal të ketë marrë një formë specifike dhe të jetë nxjerrë jashtë në botë; qëndrueshmëria e tij në kohë nuk është kusht për mbrojtjen e saj.

SI MUND TË FITOHET E DREJTA E AUTORIT? A KA NDONJË FORMALITET?

Është parim i pranuar botërisht që mbrojtja e të drejtave të autorit rrjedh automatikisht nga akti i krijimit dhe nuk varet nga asnjë formalitet. Në këtë kuptim, e drejta e autorit dallon shumë nga format e tjera të mbrojtjes së pronës intelektuale, siç janë patentat dhe markat tregtare. Konventa e Bernës parashikon që mbrojtja e të drejtës së autorit nuk mund të kushtëzohet me plotësim të ndonjë formaliteti, siç është reg-

jistrimi apo depozitimi i kopjeve. Megjithëse regjistrimi i detyrueshëm është hequr pothuajse kudo, shumë ligje shtetërore parashohin sistemet e regjistrimit vullnetar të veprave nga administrata shtetërore e të drejtave të autorit ose ndonjë organ i ngjashëm. Regjistrimi i tillë mund të shërbejë si provë e vlefshme prima facie në kontestet juridike.

A DUHET TË PËRDOR SIMBOLIN ©?

Jo, shenja © nuk është e nevojshme që vepra juaj të mbrohet. Siç është thënë më lart, vepra është e mbrojtur nga momenti i krijimit të saj, me kushtin që të ketë marrë një formë dhe të jetë origjinale. Nuk ka formalitete për mbrojtjen, nuk ka detyrim për të regjistruar veprën në ndonjë regjistër.

Simboli është krijuar nga vendet ku mbrojtja varet nga plotësimi i disa formaliteteve, njëri prej të cilëve ishte që të kishte një tregues që e drejta e autorit është kërkuar, si për shembull duke përdorur simbolin ©. Sot, përdorimi i simboleve të tilla nuk është më kërkesë juridike. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë që nuk mund ta përdorni. Në disa raste, bartësit e të drejtave përfshijnë simbolin ©, me qëllim të theksimit që vepra është e mbrojtur nga e drejta e autorit dhe se të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

ÇFARË ËSHTË AUTORI?

Konventa e Bernës, që është traktati themelor ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtës së autorit, u lejon vendeve anëtare fleksibilitet në përcaktimin se kush konsiderohet si autor (e me këtë edhe bartës origjinal i të drejtës së autorit) të një veprë literare dhe artistike. Shumica e vendeve të së drejtës kontinentale parashohin që vetëm personat fizikë mund të jenë autorë. Sipas Ligjit të Kosovës për të Drejtat e Autorit, autor është personi fizik që ka krijuar veprën.

E drejta e autorit për një vepër e që është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta krijuese të dy ose më shumë autorëve u përkasin bashkërisht autorëve (bashkëautorëve) të tillë, pavarësisht nga struktura e saj. E drejta e përdorimit të veprës në tërësi u përket bashkëautorëve së bashku. Marrëdhëniet midis bashkëautorëve rregullohen me kontratë midis tyre. Në mungesë të një kontrate të tillë, bashkëautorët gëzojnë bashkërisht të drejtat e autorit ndaj veprës, ndërsa kompensimi përkatës ndahet midis tyre, proporcionalisht me kontributet e tyre, nëse ato janë përcaktuar. Kur kontributet e bashkëautorëve nuk mund të përcaktohen, kompensimi/përfitimi ndahet në pjesë të barabarta.

Supozimi i autorësisë parashihet në Ligjin për të Drejtat e Autorit për persona, emri i të cilëve shfaqet në vepër, ose emri i të cilëve përmendet në momentin e shpalesjes së veprës. Këta persona konsiderohen autorë përveç nëse dëshmohet ndryshe.

TË PUNËSUARIT DHE TË DREJTAT E AUTORIT

Kur një vepër krijohet nga një i punësuar në ekzekutimin e detyrave të tij të punës, duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga punëdhënësi i tij, përveç nëse parashihet ndryshe me kontratë, punëdhënësi ka të drejtë të ushtrojë të drejtat ekonomike të asaj veprë, për një periudhë prej dhjetë (10) vjet nga kryerja e veprës. Kjo mund të jetë rasti vetëm kur vepra përdoret në kuadër të fushës së veprimtarisë normale të punëdhënësit, të paraparë në kohën e marrëveshjes lidhur me detyrimet e autorit.

Të drejtat i kthehen autorit të punësuar para përfundimit të atij afati në rast të vdekjes së punëdhënësit, përkatësisht në rast të likuidimit të punëdhënësit si person juridik. Nëse punëdhënësi nuk shfrytëzon të drejtat pronësore mbi atë vepër, ose i përdor ato në një mënyrë të papërfillshme, autori i punësuar ka të drejtë të kërkojë nga punëdhënësi që t'ia cetojë atij ato të drejta, kundrejt kompensimit të shpenzimeve.

Autori i punësuar mban të drejtat e autorit në lidhje me çdo vepër që nuk është krijuar në ekzekutimin e detyrave të tij të punës, si dhe për çdo përdorim të ndonjë veprë të krijuar brenda detyrave të tij të punës, e që nuk mbulohet nga veprimtaria normale e punëdhënësit, përmendur në atë paragraf.

CILAT JANË TË DREJTAT E AUTORIT?

Autori gëzon të drejta të caktuara në lidhje me veprën. Këto janë **a) të drejtat personale** (të quajtura edhe të drejta morale) dhe **b) të drejtat pronësore (të quajtura edhe të drejta ekonomike).**

Të drejtat personale/morale shprehin lidhjen që autori ka me veprën e tij, si dhe kanë për qëllim të mbrojnë personalitetin dhe reputacionin e tij. Të drejtat personale mbesin tek autori edhe nëse ai ia cedon shfrytëzimin e veprës së tij një pale të tretë. Në veçanti, autori ka të drejtë të shpalosë veprën ose të autorizojë shpalosjen e saj në çdo formë (e drejta e shpalosjes). Ai ka të drejtë të pranimit të autorësisë së tij të veprës (e drejta e autorësisë), ka të drejtën e mbrojtjes së veprës së tij nga çdo shtrembërim (e drejta e integritetit të veprës) dhe më në fund, ka të drejtë të revokojë cedimin e të drejtave të tij pronësore tek të tjerët, nëse ka arsye serioze morale për këtë, me kusht që bartësi i së drejtës të kompensohet për dëmin e shkaktuar nga revokimi i tillë i të drejtës (e drejta e tërheqjes)..

Të drejtat pronësore i ofrojnë autorit dobi ekonomike, pasi ato kanë vlerë tregtare. Përmes përdorimit të këtyre të drejtave, autori kompensohet për punën e tij, si dhe fiton mjete për të vazhduar përpjekjet e tij krijuese. Ndryshe nga të drejtat personale, të drejtat pronësore mund të tjetërsohen, si dhe në përgjithësi të trajtohen si pronë. Sipas Ligjit për të Drejtën e Autorit, autori ka veçanërisht të drejtat e mëposhtme ekskluzive për të autorizuar ose ndaluar përdorimin e veprës së tij: (a) e drejta e riprodhimit, (b) e drejta e shpërndarjes, (c) e drejta e qirasë, d) e drejta e interpretimit publik, (e) e drejta e transmetimit, (f) e drejta e komunikimit publik, (g) e drejta e ritransmetimit, (h) e drejta e ritransmetimit kabllor, e drejta e komunikimit publik nga altoparlanti ose ndonjë instrument tjetër i ngjashëm që transmeton me shenja, tinguj apo imazhe, transmetimin e veprës, (j) e drejta e vënies interaktive në dispozicion të publikut, (k) e drejta e përkthimit, (l) e drejta e adaptimit (e drejta për krijimin e veprës derivative). Autorët, në raste të caktuara, mund të kenë edhe të drejtë ekskluzive të autorizimit apo ndalimit të huazimit, ndërsa në raste të tjera kanë vetëm të drejtën e thjeshtë për shpërblim të drejtë për huadhënien.

TË DREJTAT MORALE	TË DREJTAT EKONOMIKE
e drejta e shpalosjes	riprodhimi i veprës së tij tërësisht ose pjesërisht
e drejta e autorësisë	shpërndarja e kopjeve të veprës së tij në çfarëdo forme
e drejta për integritetin e veprës	e drejta e interpretimit publik
e drejta e tërheqjes	e drejta e transmetimit dhe ritransmetimit
	e drejta e komunikimit publik
	e drejta e vënies interaktive në dispozicion për publikun
	e drejta e ritransmetimit kabllor, e drejta e komunikimit publik nga altoparlanti ose ndonjë instrument tjetër analog që transmeton me shenja, tinguj ose imazhe, transmetimi i veprës
	përkthimi i veprës
	përshtatja e veprës
	huazimi publik ose marrja me qira e veprës

Të japim një shembull:

Supozojmë se keni shkruar një këngë, d.m.th. vepër muzikore, me tekst, e cila nuk është porositur, as e krijuar gjatë detyrave tuaja të punës e as nuk është e lidhur me to.

Në momentin që përfundoni veprën, lind e drejta juaj e autorit. Ju jeni autori i veprës; kjo e drejtë e autorësisë (që i përket familjes së të drejtave morale) ju jep fuqinë të pengoni cilindo tjetër që të thotë se ai/ajo është autori. Ju jeni ai që vendosni nëse dhe kur do të publikohet kënga (e drejta e shpalosjes, e drejta morale); askush tjetër nuk e ka këtë pushtet përveç teje. Në momentin që shpaloset vepra juaj, lindin të drejtat tuaja ekonomike; të drejtat ekonomike janë të lidhura me shfrytëzimin e veprës.

Për të shfrytëzuar veprën tuaj, mund t'i drejtoheni një producenti që do të publikojë punën tuaj (ose mund ta bëni vetë, duke qenë vetë producent). Shfrytëzimi mund të përfshijë shfrytëzimin përmes një mjeti bartës fizik ose përmes internetit. Shfrytëzimi si bartës fizik do të thotë që producentit i duhet të riprodhojë veprën (në disa bartës fizikë) e më pas të shpërndajë këta bartës fizikë, pra t'i shesë ato për publikun. Është e mundur që bartësit fizikë të përdoren për huazim apo qiradhënie; këto janë të drejta të tjera ekonomike. Shpërndarja, qiradhënia dhe huazimi presupozojnë që riprodhimi tashmë ka ndodhur; përveç kësaj, këto të drejta vlejné vetëm në mjedisin fizik (jo atë virtual).

Pasi të keni nxjerrë veprën tuaj, ju me siguri do të zgjidhni prezantimin ose interpretimin e saj në publik dhe në përgjithësi komunikimin e veprës para publikut përmes transmetimit. Kjo do të thotë që vepra juaj do të luhet nga radiot, ose ndoshta TV-të (e drejta e transmetimit) dhe ndoshta do të interpretohet në kafeteri (e drejta e interpretimit publik). Transmetimi mund të ndodhë jo vetëm përmes sinjaleve tokësore (TV tradicional), por edhe përmes satelitit ose kabllot, që janë prapë të drejta të ndryshme.

Duke marrë parasysh që jemi duke jetuar në epokën e internetit, me siguri do të vendosni ta shfrytëzoni veprën tuaj edhe në Internet, përmes platformave të palëve të treta ose përmes faqes tuaj të internetit. Atje, vepra juaj do të jetë në dispozicion sipas kërkesës, që do të thotë që kushdo nga publiku mund të marrë këngën sa herë që dëshiron (imagjinoni për shembull Youtube); në këtë rast, ju do ta vini në dispozicion këngën tuaj në mënyrë interaktive (që është prapë e drejtë ekonomike). Në disa raste, kënga do të jetë në dispozicion për shkarkim (download); shkarkimi i tillë bën pjesë në të drejtën e riprodhimit.

Tani, të supozojmë që kënga juaj shënon sukses të madh, si dhe një artist italian dëshiron të përkthejë tekstin në italisht, si dhe ta përshtasë muzikën në ritëm pak më italian. Në këtë rast, artisti duhet të kërkojë leje për përkthimin dhe përshtatjen e veprës suaj (të dyja të drejta ekonomike). Nëse italiani vepron pa leje, ai/ajo shkel të drejtat tuaja morale dhe ekonomike. Kjo do të thotë që nëse kënga përkthehet dhe përshtatet pa leje, përveç të drejtës ekonomike (përshtatja, përkthimi, riprodhimi dhe mbase edhe komunikimi publik dhe vënia në dispozicion, si të drejta, nëse artisti italian e publikon atë në internet, ose e drejta e transmetimit nëse luhet në TV ose radio), do të ketë shkelje edhe të të drejtës së integritetit (sepse kënga shtrembërohet pa lejen tuaj).

CILËT JANË KUFIJTË E LIGJIT PËR TË DREJTËN E AUTORIT?

E drejta e autorit është e drejtë absolute dhe ekskluzive, që karakterizohet nga kufijtë e saj të pandashëm: origjinaliteti i veprës, afati i kufizuar i mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe përjashtimet dhe kufizimet e të drejtave të autorit.

Për më tepër, siç u shpjegua më sipër, e drejta e autorit nuk mbron idetë. Kjo do të thotë që dy persona mund të kenë të njëjtën ide për të pikturuar një shportë me fruta, por rezultatet do të jenë të ndryshëm. Ose, dy persona mund të kenë të njëjtën ide për të shkruar një histori për pesë miq që takohen rregullisht dhe janë pak të krisur, por nuk mund ta kopjojnë historinë e serisë "Friends" pa lejen e bartësit të së drejtës. Shpesh i referohemi dikotomisë së shprehjes/idesë. Kjo do të thotë që ideja mund të jetë e njëjtë tek dy autorë, por shprehja e idesë (pra rezultati) do të jetë ndryshe. Dy piktorë që ulen në të njëjtin moment para të njëjtit peizazh: ata shohin të njëjtën temë, por e shprehin ndryshe.

A JANË AUTORËT E HUAJ TË MBROJTUR NË KOSOVË

E drejta e autorit ka natyrë territoriale. Kjo do të thotë që autorët janë të mbrojtur në territorin e tyre shtetëror. Sidoqoftë, legjislacioni i Kosovës, duke ndjekur shembullin e të gjitha konventave ndërkombëtare dhe legjislacionit të BE-së, përmban klauzolën e trajtimit të shtetasit, që do të thotë se të huajt dhe shtetasit duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë.

A MUND TË BARTEN TË DREJTAT EKONOMIKE DHE MORALE?

Autori mund të bartë të drejtat e tij ekonomike tek një palë e tretë.

Në shembullin tonë më lart, nëse i drejtoheni një kompanie produksioni për të publikuar këngën tuaj (dhe vazhdoni me shfrytëzimin), ju duhet t'ia bartni të drejtat tuaja kompanisë së produksionit.

Të drejtat ekonomike dhe të drejtat e tjera që paraqiten pas vdekjes së autorit barten në pajtim me dispozitat për trashëgiminë.

Të drejtat morale, duke qenë personale të autorit, nuk mund të barten me cedim apo licencë. Sidoqoftë, pëlqimi nga autori për kryerjen e një veprimi që përndryshe mund të cenojë të drejtën e tij të integritetit konsiderohet si mënyrë e ushtrimit të kësaj të drejte, dhe kjo e detyron atë.

Në shembullin tonë, kjo do të thotë që nëse autorizoni artistin italian të përshtatë dhe të përkthejë veprën tuaj, nuk mund të pretendoni shkelje të së drejtës suaj të integritetit, sepse kur autorizoni veprimet, ju jepni pëlqimin për ndryshimet që artisti italian do të bënte në këngën tuaj.

E drejta e pretendimit të autorësisë dhe emërimit, si dhe e drejta e integritetit moral të autorëve mbrohen pa asnjë kufizim kohor. Pas vdekjes së autorit, mbrojtja e këtyre të drejtave merret përsipër nga personi fizik ose personi juridik të cilit autori ia ka besuar në testamentin e tij; në mungesë të një personi ose subjekti të tillë juridik, nga trashëgimtarët e autorëve, si dhe në mungesë të trashëgimtarëve, nga ndonjë organizatë që merr përsipër mbrojtjen e të drejtave të autorit.

ÇFARË DO TË THOTË BARTËS I SË DREJTËS?

Bartësi i të drejtës është personi që mban të drejtat e parapara në Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Ky mund të jetë autori ose bartësi i të drejtës së përafërt, ose mund të jetë edhe personi i cili ka përvetësuar ligjërisht (me kontratë ose trashëgimi), të drejtat në fjalë, pra pasardhësi.

Në shembullin tonë më lart, deri në momentin që ju i bartni të drejtat tuaja ekonomike tek producenti, ju (autori) jeni bartës i të drejtës. Pasi t'i bartni ato te producenti, ai producent bëhet bartës i të drejtës.

TË DREJTAT E PËRAFËRTA

ÇFARË NËNKUPTOJNË TË DREJTAT E PËRAFËRTA?

Përveç të drejtës së autorit, ka disa të drejta të tjera që lidhen me të drejtat e autorit, të quajtura të drejta të përafërta, sepse janë të lidhura ose anësore ndaj të drejtave të autorit, por nuk janë rezultat i vetë krijimit. Ato lidhen me të drejtat e autorit në kuptimin që kontributi i bartësve të të drejtave të përafërta është i domosdoshëm ose për

të përfunduar veprën ose për t'i mundësuar publikut të arrijë tek vepra. Këta bartës të të drejtave janë: interpretuesit (p.sh. këngëtarët, aktorët), prodhuesit e fonogramave (p.sh. Produksionet), producentët e filmave, subjektet transmetuese (p.sh. kanalet televizive) dhe shtëpitë botuese.

Le të kthehemi në shembullin tonë:

Që vepra të arrijë tek publiku, duhet të këndohet nga interpretuesi/këngëtari. Muzika duhet të luhet nga muzikantët ndërsa fonogrami të prodhohet nga prodhuesi i fonogramit. Këngëtari, muzikanti dhe producenti janë bartës të të drejtave të përafërta. Radio-stacioni transmeton këngën, si organizatë transmetuese (për bartëse e të drejtës së përafërt).

Kështu, publiku i qaset veprës së krijuar nga autori(ët) e muzikës dhe tekstit.

PSE NA DUHEN TË DREJTAT E PËRAFËRTA - ARSYETIMI

Kontributi i interpretuesve konsiderohet të jetë i një natyre krijuese ndër-
sa, në të njëjtën kohë, interpretimi është shumë i rëndësishëm për thjesht
ekzistencën e veprës; megjithatë, këto nuk janë krijime.

Producentët dhe organizatat transmetuese mbrohen për investimet e tyre;
është e rëndësishme të dihet sot që producentët dhe organizatat trans-
metuese vazhdojnë të investojnë në krijime kulturore (që është e rrallë në
kohën e Internetit) dhe për këtë arsye, kontributi i tyre duhet të shpërblehet.

CILAT JANË TË DREJTAT EKONOMIKE TË BARTËSVE TË TË DREJTAVE TË PËRAFËRTA?

Bartësit e të drejtave të përafërta nuk gëzojnë të njëjtat të drejta ekonomike,
edhe pse disa prej tyre përkojnë.

Interpretuesve u jepen të drejtat e mëposhtme:

(a) fiksimi i interpretimeve të tyre të pafiksuar, (b) riprodhimi i fiksimeve të
interpretimeve të tyre, (c) shpërndarja e fiksimeve të interpretimeve të tyre,
(d) qiradhënia e fiksimeve të interpretimeve të tyre, (e) huazimi i fiksimeve të
interpretimeve të tyre, (f) transmetimi i interpretimeve të tyre, me përjashtim
të rasteve kur interpretimi është fiksuar ose transmetuar më parë, (g) komu-
nikimi publik i interpretimeve të tyre, me përjashtim të rasteve kur inter-
pretimi është fiksuar ose transmetuar më parë, (h) ritransmetimin kabllor
të interpretimeve të tyre, (i) vënia interaktive në dispozicion të fiksimeve të
interpretimeve të tyre.

Sidoqoftë, kur interpretuesit marrin pjesë në një fonogram të publikuar për
qëllime komerciale, ata nuk mund të autorizojnë e as të ndalojnë komu-
nikimin publik të fonogramit, ose qiradhënien e tij. Për këto përdorime të
fonogramit, interpretuesit mund të kërkojnë vetëm shpërblimin e duhur
përmes SHAK-së.

Prodhuesit e fonogramit kanë të drejtën ekskluzive të lejojnë ose ndalojnë:

(a) riprodhimin e fonogrameve të tyre, (b) shpërndarjen e fonogrameve të
tyre, (c) qiradhënien dhe huazimin publik të fonogrameve të tyre, (d) ritrans-
metimin kabllor të fonogrameve të tyre, (e) vënien interaktive në dispozicion
të fonogrameve të tyre.

Kur fonogrami publikohet për qëllime komerciale, producenti nuk mund të
autorizojë e as të ndalojë komunikimin publik të fonogramit. Për këto për-
dorime të fonogramit, producentët mund të kërkojnë vetëm shpërblimin e
duhur përmes SHAK-së

Producentët e filmave kanë të drejtën ekskluzive të lejojnë ose ndalojnë:

(a) riprodhimin e filmave të tyre, (b) shpërndarjen e filmave të tyre, (c) qi-
radhënien dhe huazimin publik të kopjeve të filmave të tyre, (d) vënien inter-
aktive në dispozicion publik të filmave të tyre.

Shërbimi medial audioviziv (ose organizata transmetuese) ka të drejtën e:

(a) fiksimit të transmetimeve të tyre, (b) riprodhimit të fiksimeve të transmetimeve të tyre, (c) shpërndarjes së fiksimeve të transmetimeve të tyre, (d) ritransmetimit të transmetimeve të tyre, (e) ritransmetimit kabllor të transmetimeve të tyre, (f) komunikimit publik të transmetimeve të tyre në vende ku hyrja/qasja bëhet me pagesë, (g) vënies interaktive në dispozicion publik të fiksimeve të transmetimit të tyre.

A KANË TË DREJTA MORALE BARTËSIT E TË DREJTAVE TË PËRAFËRTA?

Nga bartësit e të drejtave të përafërta, vetëm interpretuesit kanë të drejta morale. Më konkretisht, interpretuesit kanë të drejtën ekskluzive që a) emri, pseudonimi apo shenja e tyre të tregohet me rastin e shfrytëzimit të interpretimit të tyre, si dhe b) të kundërshtojnë çdo deformim, shëmtim apo shfrytëzim të interpretimit që mund të cenojnë nderin dhe namën e tyre.

Producentët dhe organizatat transmetuese nuk gëzojnë të drejta të tilla morale; kjo është logjike, sepse ajo që mbrohet në rastin e producentëve dhe organizatave transmetuese është investimi i tyre. Këta nuk kanë kontribut krijues. Për më tepër, në shumicën e rasteve, ata nuk janë as persona fizikë, por kompani.

A MUND T'I BARTË TË DREJTAT E TIJ BARTËSI I TË DREJTËS SË PËRAFËRT?

Bartësi i të drejtës së përafërt mund të bartë të drejtat e tij ekonomike tek një palë e tretë. Të drejtat e interpretuesve po ashtu mund të trashëgohen, si në rastin e autorëve.

Në shembullin tonë më lart, derisa këngëtari i këngës suaj, d.m.th. interpretuesi t'i cetojë të drejtat producentit, ashtu që producenti të mund të shfrytëzojë veprën muzikore.

Në disa raste, ligji parasheh që të ketë ndodhur bartja, edhe kur kjo nuk ka ndodhur në të vërtetë. Kjo është ajo që ligji e quan supozim i bartjes, si dhe parashihet kur për shembull interpretuesi lidh kontratë me producentin për produksionin filmik.

DISPOZITAT E ZAKONSHME PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA

PËR ÇFARË PERIUDHE OFROHET MBROJTJA E TË DREJTAVE TË AUTORIT DHE TË DREJTAVE TË PËRAFËRTA?

Mbrojtja e një veprë krijuese përmes të drejtës së autorit nuk zgjat përgjithmonë. Mbrojtja që ofrohet me krijimin e veprës zgjat për gjithë jetën e autorit dhe 70 vjet pas vdekjes së tij. Pas kësaj periudhe, vepra krijuese bie në domenin publik dhe mund të përdoret nga publiku në mënyra të reja. Sidoqoftë, të drejtat personale të autorit, ato që mbrojnë lidhjen e tij me veprën, personalitetin dhe famën e tij mbrohen pa kufizime në kohë. Të drejtat e shpalosjes dhe tërheqjes zgjasin për gjithë jetën e autorit. Kjo mbrojtje e kufizuar në kohë është një nga karakteristikat kryesore të Ligjit për të drejtat e autorit, që e dallon atë nga prona materiale, e cila zgjat përgjithmonë.

Të drejtat e përafërta mbrohen si më poshtë:

e drejta e interpretuesit zgjat 50 vjet nga interpretimi i veprës dhe 70 vjet në rastin e veprave muzikore

të drejtat e prodhuesit të fonogrameve ose veprave audiovizive skadojnë 70, respektivisht 50 vjet nga fiksimi i veprës

O rganizatat transmetuese, skadojnë 50 vjet nga komunikimi i programit.

Në shembullin tonë, kjo do të thotë që nëse keni shkruar vetëm tekstin e këngës dhe keni përdorur muzikë të krijuar nga një autor që ka vdekur në vitin 1950, nuk keni nevojë për autorizim nga autori. Bëni kujdes megjithatë, pasi të drejtat personale qëndrojnë në kohë dhe mbrohen përgjithmonë. Prandaj, përdorimi i muzikës ekzistuese nuk duhet të bëhet me shkelje ndaj autorit.

LLOJI I TË DREJTËS	KOHËZGJATJA
Të drejtat ekonomike të autorit	Nga krijimi deri në 70 vjet nga vdekja e autorit
E drejta e autorit për autorësi dhe e drejta e integritetit	Pa kufizim në kohë
Të drejtat e autorit për shpalosje dhe tërheqje	Për gjithë jetën e autorit
Interpretuesi i veprave muzikore	70 vjet nga interpretimi
Interpretues i veprave audiovizive	50 vjet nga interpretimi
Prodhuesi i fonogrameve	70 vjet nga fiksimi
Producent i filmave	50 vjet nga fiksimi
Organizata transmetuese	50 vjet nga komunikimi i programit.

RESPEKTIMI I VEPRAVE EKZISTUESE

Përkthyesit dhe autorët e veprave të tjera derivative gëzojnë të drejtën e autorit mbi përkthimet, përshtatjet, aranzhimet ose transformimet e tjera të bëra prej tyre.

Përkthimi ose ndonjë vepër tjetër derivative mund të krijohet vetëm nëse autori i veprës origjinale e autorizon. E drejta e autorit e një përkthyesi ose e autorit të ndonjë veprë tjetër derivative nuk mund të cenohet të drejtat e autorit të veprës origjinale e cila është përkthyer, përshtatur, aranzhuar ose transformuar ndryshe.

Është gjithashtu e rëndësishme të respektohen të drejtat morale të autorit të veprave paraprakisht ekzistuese që ju integroni në krijimet tuaja. Nëse gjeni përmbajtje interesante në zyrën e kolegut tuaj, jeni të detyruar të kërkonti autorizimin e tij, nëse dëshironi ta përdorni. Ju duhet të theksoni emrin e tij dhe burimin kur përdorni veprën e tij ose duke e prezantuar para publikut ose duke e riprodhuar atë. Autori i veprës ekzistuese për shembull mund t'ju ndalojë të riprodhoni në veprën tuaj ekstraktin e filmit të tij pa kolonë zanore. Ose të përdorni veprën e tij, për shembull në një vepër që mohon holokaustin.

Nëse, në shembullin tonë, doni të krijoni një këngë të re, por duke përdorur vargjet e një poezie ekzistuese që ju pëlqen, ju duhet autorizimi. Tani, në rast të veprave letrare, gjithmonë duhet të keni parasysh se është shumë e mundur që të gjitha ose disa të drejta të jenë bartur tek ndonjë botues/redaktor. Kjo është arsyeja pse ju duhet të pyesni autorin e veprës ekzistuese që bart të drejtat dhe të kërkonti nga autori ose ai tek i cili janë bartur drejtat (shembull, redaktori) për të garantuar që ai/ajo është me të vërtetë bartës i të drejtave. Kjo vlen për të drejtat ekonomike.

Sa i përket të drejtave morale, duhet të kërkonti autorizim nga vetë autori, sepse, siç e shpjeguam, të drejtat morale qëndrojnë gjithmonë me autorin. Prandaj këshillohet, nëse dëshironi të përdorni një vepër ekzistuese, të kërkonti leje nga autori për të drejtat morale, duke përshkruar mënyrën se si do të përdorni veprat ekzistuese. Përndryshe, rrezikoni të shkelni të drejtën e integritetit të autorit. Sigurohuni gjithashtu që t'i njihni meritat autorit të veprës ekzistuese, pra të përmendni emrin e tij.

PËRJASHTIMET DHE KUFIZIMET

Nëse po mendoni të përdorni një vepër ekzistuese që është ende nën mbrojtje për të krijuar një të re, duhet të merrni leje nga bartësit e të drejtave. Në disa raste, megjithatë, ligji lejon përdorimin pa qenë e nevojshme të merret autorizimi. Kjo ndodh kur përdorimi bën pjesë në ndonjë përjashtim ose kufizim të parashikuar me ligj.

Më konkretisht, për të gjetur baraspeshën e duhur midis interesave të publikut për qasje në informacion dhe njohuri, si dhe të drejtave ekskluzive të autorit, mbrojtja e të drejtës së autorit i nënshtrohet kufizimeve dhe përjashtimeve.

Dy format themelore të përjashtimeve dhe kufizimeve janë:

- Përdorimi i lirë, pra përdorimi i veprës pa ndonjë autorizim apo kompensim; dhe
- licenca jo-vullnetare ose të detyrueshme, që do të thotë se kompensimi duhet t'i paguhet bartësit të të drejtës për shfrytëzim të paautorizuar.

Licenca jo-vullnetare ose e detyrueshme është rasti i përjashtimit/kufizimit të përdorimit privat të veprës së mbrojtur nga e drejta e autorit, siç është regjistrimi në shtëpi ose riprodhimi për përdorim privat, për të cilin nuk jepet autorizimi. Kur zbatohet ky parim, autorët dhe bartësit tjerë të të drejtave marrin zakonisht kompensim shpërblim të drejtë ose të barasvlefshëm, i cili bazohet në një tarifë mbi pajisjet e regjistrimit bosh ose pajisjet e shpërndara tek autorët dhe bartësit e të drejtave përmes shoqatave të ad-

ministrimit kolektiv.

Përjashtimet dhe kufizimet zbatohen vetëm në raste të caktuara të cilat nuk bien ndesh me shfrytëzimin normal të veprës ose ndonjë lëndë, si dhe nuk paragjykojnë pa arsye interesat legjitime të bartësit të së drejtës. Ky është parimi i testit me tre hapa, që parashihet edhe nga Konventa e Bernës, Marrëveshja TRIPS dhe Traktatet e Internetit WIPO, si dhe Traktatet e Pekinit dhe Marrakeshit.

Ligji i Kosovës për të Drejtat e Autorit parashikon në raste të caktuara përdorimin falas të një vepre, që nënkupton përdorimin e veprës pa pëlqimin e autorit dhe pa kompensim, por me përmendjen e detyrueshme të emrit të autorit dhe origjinën e veprës, me kusht që të mos paragjykojë shfrytëzimin normal të veprës dhe interesat legjitime të autorit. Përdorimet e lejuara pa pagesë kanë të bëjnë me: (a) citime të shkurtra në një veper tjetër për qëllime si kritika ose shqyrtimi, (b) përdorimi i veprave përmes ilustrimit në botime, transmetime ose regjistrime zanore ose vizuale për mësimdhënie ose kërkime shkencore në të gjitha nivelet, (c) përdorimi i veprave të publikuara për shfaqje publike në festimet e shkollës me kusht që interpretuesit të mos kompensohen për interpretim të tillë, (d) përdorimi digjital i veprave dhe lëndëve të tjera, në kushte të caktuara, (e) riprodhimi dhe shpërndarja nga shtypi, transmetimi, komunikimi publik ose vënia interaktive në dispozicion publik e artikujve të botuar mbi tema aktuale ekonomike, politike ose fetare ose të veprave të transmetuara ose lëndëve të tjera me të njëjtin karakter, (f) përdorimi i veprave ose lëndëve të tjera në lidhje me raportimin e ngjarjeve aktuale, në masën që arsyetohet për qëllimet e informimit, (g) përdorimi i fjalimeve politike, si dhe ekstrakte të ligjëratave publike ose veprave të ngjashme ose lëndës në masën që arsyetohet për qëllime informimi, (h) përdorimi për qëllime të sigurisë publike ose për të siguruar zbatimin dhe raportimin e mirëfilltë të procedurave parlamentare, administrative ose gjyqësore, (i) regjistrimet efemerike të veprave që bëhen nga organizatat transmetuese me anë të pajisjeve të tyre dhe për transmetimet e tyre me mirëkuptimin që regjistrimet e tilla do të fshihen ose shkatërrohen pas dymbëdhjetë (12) muajsh, me përjashtim të atyre që kanë karakter të jashtëzakonshëm dokumentar, të cilat mund

të ruhen në arkivat zyrtarë të Shtetit, (j) përdorim, për dobinë e personave me aftësi të kufizuara, që lidhen drejtpërdrejt me aftësinë e kufizuara dhe janë të natyrës jo-komerciale, në masën që kërkohet për aftësinë e caktuar të kufizuara, (k) përdorimi gjatë festave fetare apo zyrtare të organizuara nga një autoritet publik, (l) përdorimi i veprave, si veprat e arkitekturës ose skulpturës, të bëra për t'u vendosur përgjithmonë në vende publike, (m) përdorim për qëllime të reklamimit të ekspozitës publike ose shitjes së veprave artistike, deri në masën që nevojitet për të promovuar ngjarjen, duke përjashtuar çdo përdorim tjetër komercial, (n) përdorim për qëllime karikature ose parodie, (o) përdorim në lidhje me demonstrimin ose riparimin e pajisjeve, (p) përdorimi i veprave punë artistike në formën e një ndërtese ose vizatimi ose plani të një ndërtese për qëllimet e rikonstruimit të ndërtesës, (q) përdorimi përmes komunikimit ose vënies interaktive në dispozicion publik, për qëllime të hulumtimit ose studimit privat, për individë të caktuar të publikut përmes terminaleve të dedikuara, në mjediset e institucioneve që janë të qasshme për publikun, të veprave dhe lëndëve të tjera që nuk i nënshtrohen kushteve të blerjes ose licencimit të cilat mbahen në koleksionet e tyre, (r) bërja e kopjeve të cilësdo vepre apo lëndë tjetër që mbahet përgjithmonë në koleksionet e tyre, në çdo format ose medium, për qëllime të ruajtjes së veprave të tilla ose lëndëve tjera dhe në masën e domosdoshme për atë ruajtje, për institucionet e trashëgimisë kulturore. Lejohet gjithashtu, pa pëlqimin e autorit ose ndonjë bartësi tjetër të së drejtës së autorit, por kundërt pagimit të kompensimit të duhur, riprodhimi i transmetimeve të bëra nga institucionet shoqërore për qëllime jo-komerciale, siç janë spitalet ose burgjet.

VEPËR

Aktet e përkohshme të riprodhimit lejohen, pa pëlqimin e autorit ose bartësve tjerë të së drejtës së autorit, si dhe pa pagimin e kompensimit me kusht që ato t'i plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme: (a) janë kalimtare ose të rastësishme, (b) janë pjesë përbërëse dhe thelbësore të një procesi teknologjik, (c) qëllimi i tyre i vetëm është të mundësojnë transmetimin në një rrjet midis palëve të treta nga një ndërmjetës; ose një përdorim i ligjshëm i një veprë, dhe (d) të mos kenë ndonjë rëndësi të veçantë ekonomike.

Riprodhimi i veprës së publikuar ligjërisht lejohet pa pëlqimin e autorit, por kundrejt pagimit të një kompensimi të duhur, nëse bëhet nga një person fizik për përdorimin e tij ekskluziv personal dhe privat, si dhe për qëllime që nuk janë as drejtpërdrejt e as tërthorazi komerciale.

Riprodhimi reprografik, me anë të fotokopjimit, po ashtu parashihet në ligj, në lidhje me raste specifike, akte si ato nga bibliotekat dhe arkivat, institucionet arsimore dhe kulturore, për qëllimin ose restaurimin ose zëvendësimin e kopjeve të humbura ose të dëmtuara, për ndonjë bibliotekë ose arkiv, që nuk është për ndonjë dobi drejtpërdrejt apo tërthorazi ekonomike apo komerciale, për të plotësuar nevojat e personave fizikë që do të përdorin kopjen e marrë në mënyrë të tillë për qëllime të studimit privat ose hulumtimeve jo-komerciale; për institucione mësimdhënëse, në numër kopjesh të nevojshme për ilustrim në klasa.

“Gërmimi” i teksteve dhe të dhënave për qëllime të hulumtimeve shkencore ose me kusht që përdorimi i veprave dhe lëndëve të tjera të përmendura në atë paragraf të mos jenë rezervuar shprehimisht nga bartësit e të drejtave e tyre në mënyrë të përshtatshme, siç janë mënyrat e lex-

imit makinerik, në rastin e përmbajtjes së vënë në dispozicion publikisht në internet është një tjetër përjashtim i lejueshëm.

Së fundmi, Ligji për të Drejtat e Autorit parasheh përdorime të lejuara të veprave “jetime” për biblioteka, institucione arsimore dhe muze të qasshëm për publikun, si dhe nga arkivat, institucionet e trashëgimisë filmike ose audio si dhe organizatat publike transmetuese, të themelura në Republikën e Kosovës, me qëllim të arritjes së synimeve që lidhen me misionet e tyre të interesit publik, si dhe për përdorimin e veprave të nxjerra jashtë qarkullimit dhe lëndëve tjera nga institucionet e trashëgimisë kulturore.

Personat me dëmtime në të parë apo paaftësi leximi mund të riprodhojnë, për përdorimin e tyre personal, vepra letrare të botuara që janë në dispozicion në tekst ose në formatin audio, si dhe regjistrime grafike të veprave muzikore, ose mund t'i riprodhojnë ato ashtu që të konvertohen në një format të qasshëm. Ky autorizim përfshin gjithashtu ilustrime të të gjitha llojeve që gjenden në veprat letrare ose muzikore. Mund të prodhohen vetëm kopje nga veprat në të cilat personat me dëmtime në të parë apo paaftësi leximi kanë qasje të ligjshme.

Aktet nuk kërkojnë autorizim nga autori ose ndonjë bartës tjetër i të drejtës së autorit kur janë të domosdoshme për përdorimin e një programi kompjuterik ose një databaze nga blerësi i ligjshëm i tij, në pajtim me destinimin e tij/saj, përfshirë korrigjimin e gabimeve. Edhe zbërthimi (dekompilimi) i programeve kompjuterikë lejohet në kushte të caktuara.

INTEGRIME TË LIGJSHME ME LICENCË PA PAGESË

KODI ME BURIM TË HAPUR

Shumë zhvillues përdorin softuerë me burim të hapur, që do të thotë softuer që ofrohet për përdorim falas, për të zhvilluar më shpejt sistemet e tyre.

Licencat me burim të hapur janë krijuar nga bota e softuerit të lirë, por ato po përhapen tashmë edhe në fusha të tjera. Këto u nënshtrohen të njëjtave kushte vlefshmërie si çdo cedi i ligjshëm i të drejtave dhe krijojnë detyrime ligjore midis palëve. Ndryshe nga licencat tradicionale të së drejtës së autorit që kufizojnë përdorimin e softuerit, licencat e hapura lejojnë që softueri të shpërndahet, të përdoret dhe modifikohet nga sa më shumë njerëz, ashtu që të gjithë të mund ta përshtatin softuerin me nevojat e tyre specifike dhe të bëjnë vetë korigjimet.

Përdorimi i softuerit me burim të hapur është i licencuar me kushte specifike. Licencat kategorizohen në licenca “copyleft” ose licenca lejuese. Të dyja, licencat copyleft dhe ato lejuese i mundësojnë përdoruesve të kopjojnë, shpërndajnë dhe ndryshojnë lirisht softuerin që i përdor ato; programe të tilla me burim të hapur i nënshtrohen prapë ligjit për të Drejtat e Autorit; janë kushtet e tyre kontraktuale që i bëjnë ndryshe nga e drejta e autorit (pa ekskluzivitet, etj.).

Kodi burimor i licencuar me “Copyleft” (si GLP etj), obligon zhvilluesit të përdorin në programin e tyre (që përfshin kodin fillestar burimor me Copyleft) të njëjtën licencë; kjo do të thotë që programi i ri do t'u vihet në dispozicion palëve të treta për ta kopjuar, shpërndarë dhe modifikuar atë. Prandaj, nuk mund të kërkohen të drejta pronësore ndaj softuerit të krijuar rishtas, i cili përfshin kodin burimor të hapur që ekziston, i vënë në dispozicion me licencën Copyleft.

Vlefshmëria e licencave me burim të hapur u konfirmua fillimisht nga Gjykata e Mynihut, e cila vendosi më 2004 që shpërndarja e softuerit në kundërshtim me kushtet e Licencës së Përgjithshme Publike përbënte shkelje të së drejtës së autorit. Vendimi i Gjykatës së Frankfurtit, më 6 shtator 2006, mori të njëjtin drejtim. Në fund të fundit, kodi burimor i shpërndarë me licenca me burim të hapur prapë bën pjesë në të drejtat e autorit. Klauzolat e licencave me të cilat vihet në dispozicion kodi burimor, qoftë me “Copyleft” ose lejuese, duhet të respektohen. Nëse zhvilluesi nuk respekton licencën e caktuar për përdorimin e kodit me burim të hapur, ka shkelje të ligjit të së drejtës së autorit (e drejtë kontraktuale e autorit).

KRIJIMET E PËRBASHKËTA (CREATIVE COMMONS - CC)

Licencat e këtij lloji lëvizin në të njëjtin drejtim me licencat “e hapura”. Këto janë kontrata model, që synojnë të lejojnë përdorimin falas të veprave në internet, duke bartur simbolin CC. Këto licenca i lejojnë përdoruesit të vazhdojë me përdorime të caktuara të veprës, duke zbatuar kushtet e vendosura nga bartësit e të drejtave. Përdoruesit nuk kanë nevojë të kërkojnë leje për përdorimin e veprave CC. Vlefshmëria e licencave CC është konfirmuar nga gjykatat spanjolle dhe holandeze.

Qëllimi i CC-së është të krijojë një sektor të ri publik konvencional, krijimin e të mirave të përbashkëta në bazë të licencave të ofruara nga vetë autorët. Në këtë mënyrë, përmbajtja e veprave para-ekzistuese mund të qaset dhe të përdoret nga të gjithë, ku përdoruesit fundorë ose autorët lejojnë krijimin e veprave derivative brenda kulturës së remiksimit. Këto licenca konsiderohen më liberale dhe sigurojnë fleksibilitet dhe synojnë përhapjen dhe qarkullimin masiv të punimeve.

Licencat CC janë zgjidhja e ndërmjetme: të drejtat e autorit mbrohen, shpërndarja e veprave dhe ripërdorimi i tyre lejohet, por vetëm brenda kufijve të zgjedhur nga vetë krijuesi. Prandaj, është një ushtrim tjetër individual i së drejtës bazuar në logjikën e ndarjes dhe ripërdorimit të veprave dhe jo në logjikën e kontrollit absolut të qasjes në to.

CC-të janë kontrata ligjërishit detyruese; janë të parevokueshme dhe me shtrirje globale. Secila licencë përbëhet nga tre nivele funksionale: a) e lexueshme nga të gjithë që përmban një përmbledhje të kushteve themelore të licencës (Titulli Commons), b) teksti ligjor që përfshin kushtet kontraktuale të licencës (Kodi Ligjor) dhe c) forma makinerike që përmban meta të dhënat dhe mundëson identifikimin e veprave që vihen në dispozicion në formë digjitale me licenca CC nga motorët e kërkimit (Meta Data).

Ekzistojnë gjashtë lloje të licencave të ndryshme, të renditura nga më lejuet e deri më së paku lejuese:



CC BY: Kjo licencë i lejon ripërdoruesit të shpërndajnë, remiksojnë, përshtatin dhe ndërtojnë mbi atë material në çdo medium apo format, me kusht që t'i atribuohet krijuesit. Licenca lejon përdorimin komercial.

CC BY përfshin elementët e mëposhtëm:



BY Duhet përmendur krijuesi



CC BY-SA: Kjo licencë i lejon ripërdoruesit të shpërndajnë, remiksojnë, përshtatin dhe ndërtojnë mbi atë material në çdo medium apo format, me kusht që t'i atribuohet krijuesit. Licenca lejon përdorimin komercial. Nëse e remiksoni, përshtatni apo ndërtoni mbi material, duhet të licenconi materialin e modifikuar në kushte identike.

CC BY përfshin elementët e mëposhtëm:



BY Duhet përmendur krijuesi



SA Përshtatjet duhet të shpërndahen nën të njëjtat kushte



CC BY-NC: Kjo licencë i lejon ripërdoruesit të shpërndajnë, remiksojnë, përshtatin dhe ndërtojnë mbi atë material në çdo medium apo format, me kusht që t'i atribuohet krijuesit.



BY Duhet përmendur krijuesi





NC Lejohen vetëm përdorime jokomerciale të veprës



CC BY-NC-SA: Kjo licencë i lejon ripërdoruesit të shpërndajnë, remiksojnë, përshtatin dhe ndërtojnë mbi atë material në çdo medium apo format, me kusht që t'i atribuohet krijuesit. Nëse e remiksoni, përshtatni apo ndërtoni mbi material, duhet të licenconi materialin e modifikuar në kushte identike.

CC BY-NC-SA përfshin elementët vijues:

BY  Duhet përmendur krijuesi


NC  Lejohen vetëm përdorime jokomerciale të veprës

SA  Përshtatjet duhet të shpërndahen me të njëjtat kushte



CC BY-ND: Kjo licencë i lejon ripërdoruesit të kopjojnë dhe shpërndajnë materialin apo formatin vetëm në formë të papërshtatur, si vetëm me kushtin që t'i atribuohet krijuesit. Licenca lejon përdorimin komercial.

CC BY-ND përfshin elementët e mëposhtëm:


BY  Duhet përmendur krijuesi

ND  Nuk lejohen derivativet e as përshtatjet e veprës



CC BY-NC-ND: Kjo licencë i lejon ripërdoruesit të kopjojnë dhe shpërndajnë materialin apo formatin vetëm në formë të papërshtatur, vetëm për qëllime jokomerciale, si dhe vetëm me kushtin që t'i atribuohet krijuesit.

CC BY-NC-ND përfshin elementët vijues:

BY  Duhet përmendur krijuesi

NC  Lejohen vetëm përdorime jokomerciale të veprës

ND  Nuk lejohen derivativet e as përshtatja e veprës

PO SIKUR TË PËRDOR NJË VEPËR QË KAM GJETUR NË INTERNET? A NUK ËSHTË AJO E LIRË NGA TË DREJTAT?

Nuk mund të konsideroni që veprat e gjetura në internet (për shembull një fotografi) mund të përdoren pa autorizim. Nëse nuk ka ndonjë indikacion në lidhje me përdorimin e veprës, nuk duhet ta përdorni. Kontrolloni kushtet e përdorimit të faqes për të parë nëse ekziston një mundësi e tillë. Nëse e merrni veprën dhe e përdorni atë pa autorizim, bartësi i të drejtës mund të paraqitet dhe të kërkojë dëmshpërblim për shkelje. Vetëm nëse ka tregues, si CC ose të ndonjë lloji tjetër, që përshkruan përdorimin e mundshëm, mund ta përdorni veprën, duke respektuar kushtet specifike të vendosura nga bartësit e të drejtave. Duhet të jeni gjithmonë të kujdesshëm kur përdorni vepra nga interneti, sepse, edhe nëse ka një indikacion të lejes, nuk mund të jeni i sigurt se ai që ka vendosur kushtet për përdorim (kontratën) është bartësi i të drejtës.

Në shembullin tonë, të supozojmë që ju doni të përhapni veprën tuaj muzikore përmes faqes tuaj. A do të thotë kjo se kushdo mund ta marrë atë nga faqja juaj dhe ta përdorë, për shembull në një reklamë? Sigurisht që jo. Ju duhet të autorizoni përdorimin. Ose në të kundërtën, të supozojmë se keni lexuar një poezi në një platformë, e cila ju ka pëlqyer dhe doni të krijoni muzikën për të. Ju nuk mund t'i përdorni tekstin pa autorizim nga autori, ju duhet ta kontaktoni atë dhe të kërkonin leje.

SI TË KOMERCIALIZONI TË DREJTAT TUAJA?

Një nga elementët themelorë të të drejtave të autorit është dhënia e të drejtave ekonomike autorëve, gjë që i mundëson atyre të shfrytëzojnë veprat e tyre ose individualisht ose duke autorizuar palët e treta për këtë. Autorët mund të bartin të drejtat e tyre ekonomike tek individë ose kompani që mund të tregtojnë veprat e tyre në këmbim të pagesës. Pagesat e tilla quhen tantiema (honorare - royalties). Bartja e të drejtës së autorit mund të marrë formën e cedimit ose licencës. Në rastin e cedimit, autori bart të drejtën e autorizimit apo ndalimit të vepr-

meve të caktuara që mbulojnë nga të drejtat ekonomike. Në rastin e cedimit, personi të cilit i cedohen të drejtat bëhet pronari i ri i të drejtës së autorit. Licencimi do të thotë që autori mban pronësinë, por autorizon një person të tretë për të kryer veprime të caktuara të mbuluara nga të drejtat e tij ekonomike, përgjithësisht për një periudhë të caktuar kohe dhe për një person të caktuar. Licencimi mund të marrë edhe formën e administrimit kolektiv të të drejtave.

ADMINISTRIMI KOLEKTIV

Megjithëse menaxhimi individual është një mundësi, disa të drejta ekonomike nuk mund të menaxhohen individualisht; për disa forma të shfrytëzimit, është praktikisht e pamundur të organizohet një marrëdhënie e drejtpërdrejtë kontraktuale midis përfituesve dhe përdoruesit, për shkak të sasisë së madhe dhe shpërndarjes së bartësve të të drejtave dhe përdoruesve, si dhe intervalit shumë të shkurtër midis vendimit për të përdorur një vepër dhe vetë përdorimit, që nuk i lejon përdoruesit të identifikojë përfituesit dhe të lidhë marrëveshje me ta. Mes formash të shfrytëzimit, që korrespondojnë me të drejtat ekonomike të autorëve dhe bartësve të të drejtave të përafërta, me karakteristikat e lartpërmendura, janë:

- transmetimi dhe shfaqja publike e veprave muzikore,
- ritransmetim kabllor i veprave, interpretimeve dhe produkteve të tjera të ngjashme,
- kopjimi për përdorim privat të veprave muzikore, audio-vizuale dhe zanore ose produkteve të të drejtave të përafërta (fonogramet, videogramet, etj.),
- reprografia dhe
- huazimi publik.

Në këto raste, menaxhimi kolektiv dëshmohej të jetë mënyra më e mirë si dhe në fakt, mënyra e vetme e mundshme për të mbrojtur të drejtat e bartësve dhe për të mundësuar shfrytëzimin efektiv të të drejtave ekonomike. Në një sistem të tillë, bartësit e të drejtave autorizojnë ose u japin mandat SHAK-ve që të administrojnë dhe menaxhojnë të drejtat e tyre. Kështu, menaxhimi kolektiv duhet të përfshijë midis aktiviteteve të tjera: negociatat me përdoruesit për caktimin e tarifave, dhënien e autorizimeve të përdoruesve për përdorimin e veprave dhe produkteve të tjera të ngjashme, monitorimin e përdorimit të veprave dhe produkteve të tjera të ngjashme ose përdorimin e të drejtave ekonomike të menaxhuara nga SHAK-të për anëtarët e tyre dhe bartësit e të drejtave, duke siguruar realizimin e këtyre të drejtave, mbledhin honoraret nga përdoruesit, shpërndajnë dhe paguajnë honoraret për bartësit e të drejtave, anëtarë të SHAK-ve.

Duke marrë parasysh që bartësit e të drejtave kanë nevojë të ndryshme dhe përballen me sfida të ndryshme në varësi të fushës së tyre të aktivitetit (për shembull muzikë ose audio-vizuale), SHAK-të përfaqësojnë bartësit e të drejtave në kategori specifike të veprave. Për më tepër, zakonisht SHAK-të përfaqësojnë një kategori specifike të bartësve të të drejtave (për shembull autorë ose interpretues ose producentë), ndërsa në disa raste, të drejtat specifike ekonomike (për shembull vetëm interpretimet publike ose vetëm e drejta e riprodhimit për një kategori të veçantë të veprave).

Më 12 korrik 2012, u bë një hap shumë i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të autorit në Kosovë. Dy shoqata për administrimin kolektiv të së drejtës së autorit, APIK - për fushën e muzikës dhe VAPIK - për fushën audiovizive, tashmë kanë marrë licencën nga ZDA-ja, ashtu që të administrojnë këto të drejta, duke negociuar me përdoruesit.

DOBITË E MENAXHIMIT KOLEKTIV

Për të krijuar një mjedis funksional të mirëfilltë të së drejtës së autorit, legjislacioni duhet t'u ofrojë përdoruesve qasje të lehtë për të marrë licencë për materialin e së drejtës së autorit. Administrimi kolektiv është i arsyeshëm kur marrja e licencave, për shkak të numrit dhe rrethanave të tjera të përdorimit, është e pamundur ose e pabaralizuueshme, si për interpretimet publike ose transmetim. Në veçanti, do të jetë e pamundur për një radio-stacion të negociojë drejtpërdrejt me të gjithë kompozitorët në të gjithë botën. Është e dobishme për radio-stacionet sepse mund të marrin licencë për gjithë botën në një pikë të vetme. Për kompozitorin, është e pamundur të monitorojë transmetimet në të gjithë botën të melodisë së tij hit.

Pra, në rast të përdorimeve në masë si transmetimi, menaxhimi i të drejtave individuale do të jetë i kushtueshëm dhe pothuajse i pamundur. SHAK-të krijojnë sisteme licencimi miqësore për përdoruesit - qasje e lehtë në repertorin mbarëbotëror, komoditet - me çmim të drejtë. Ato informojnë për vlerën e muzikës dhe filmave për klientët dhe ofrojnë shërbime për klientët në lidhje me përdorimin e muzikës dhe filmave, në bare, restorante, hotele, TV dhe radio stacione. Menaxhimi kolektiv më shpesh konsiderohet si mjet për të siguruar që bartësit e të drejtave të realizojnë dobinë ekonomike për punën e tyre krijuese, të paraparë me legjislacion.

Të kthehemi te shembulli ynë:

Ju jeni autori i një vepre muzikore (muzikë dhe tekst). Nëse bëheni anëtar i një SHAK-je, do të arrini të merrni honorare/kompensime sa herë që muzika juaj luhet, për shembull, në bare apo në televizione/radio, ose kur ajo merret me qira ose huazohet etj. SHAK-të kanë mekanizma të tillë që mund të çojnë në mbledhjen e honorareve tuaj për përdorime që nuk mund t'i kontrolloni vetë.

SI FUNKSIONON MENAXHIMI KOLEKTIV I TË DREJTAVE?

Në rastin e menaxhimit kolektiv, bartësi i së drejtës ende zotëron të drejtat e autorit, por menaxhimi bartet tek një subjekt tjetër juridik, një organizatë jofitimprurëse ose jo për përfitim. SHAK-ja nuk negocion për honorarin mbi baza individuale, por me licenca sipas një tarife të përbashkët për të gjithë bartësit e të drejtave të së njëjtës kategori. SHAK-ja autorizon përdorimin, me anë të licencës që mbulon të gjithë bartësit e të drejtave (licencë blanket), si dhe shpërndan

honoraret e mbledhura individualisht të bartësit e të drejtës.

Bartësi i së drejtës nuk mund të ketë më pretendim të drejtpërdrejtë ndaj përdoruesit individual, por bartësi i së drejtës parashtron kërkesa tek SHAK-ja për pagesa. Rregullat e shpërndarjes pasqyrojnë të drejtat individuale specifike që përdoren dhe paguhen, ashtu që pagesa individuale t'i bëhet secilit bartës të së drejtës.

Shtatë hapat e menaxhimit kolektiv:

Bartësit e të drejtave bartin të drejtat e tyre ose autorizojnë SHAK-të për të menaxhuar të drejtat e tyre sipas legjislacionit vendor

SHAK-ja regjistron bartësit e të drejtave dhe veprat e interpretimet e tyre në databazat e tyre, ashtu që të krijojë bazën për shpërndarjen individuale

SHAK-ja negocion pagesën me përdoruesit dhe licencon përdorimin

SHAK-ja mbledh pagesat në emër të bartësve të të drejtave

TSHAK-ja monitoron përdorimin e veprave

SHAK-ja shpërndan individualisht të ardhurat në bazë të përdorimit aktual të veprave, si dhe i paguan bartësve individuale të së drejtës, në pajtim me planin e shpërndarjes

SHAK-ja nënshkruan marrëveshje reciproke me SHAK-të homologe jashtë vendit si dhe transferon pagesa përtej kufijve.

UDHËZIME PËR KRIJIMIN E MENAXHIMIT KOLEKTIV PËR TË DREJTAT E PËRAFËRTA

Menaxhimi bazë kolektiv i të drejtave të përafërta në parim është mjaft i thjeshtë, por kompleks në praktikë:

SHAK-ja regjistron të dhënat nga anëtarët në regjistrimet e tyre zanore;

SHAK-ja negocion tarifat dhe mbledh kompensimet nga përdoruesit, si radio dhe stacione televizive, hotele, restorante, qendra fitnesi etj.;

SHAK-ja merr raporte nga përdoruesit për transmetimin dhe interpretimin publik të muzikës së regjistruar;

Në fund, SHAK-ja shpërndan honoraret e mbledhur - pas zbritjes së kostove - bartësve individualë të të drejtave, bazuar në informacionin nga listat e transmetimeve nga përdoruesit.

Kështu, databaza me informata të regjistrimeve zanore për të gjithë interpretuesit dhe producentët muzikorë, së bashku me softuerin e shpërndarjes që lidh honoraret në ardhje, raportet e përdoruesit dhe databaza janë shtylla kurrizore e çdo SHAK-je që mbledh dhe shpërndan kompensimet për të drejtat e përafërta. "Të dhënat janë mbreti" dhe prioriteti numër 1 për SHAK-të.

Prioriteti i dytë është ndërlidhja me vullnetarët e caktuar midis interpretuesve dhe producentëve muzikorë, si dhe emërimi i një interpretuesi të famshëm për të qenë fytyra e projektit.

Prioriteti i tretë është zhvillimi i strategjive të duhura të komunikimit dhe ngritja e vetëdijes për të drejtat e interpretuesve dhe producentëve muzikorë.

Kriteret e suksesit për një SHAK të re janë pagesat për bartësit e të drejtave, vendas dhe të huaj. Numri i anëtarëve është i rëndësishëm për të pasur mbështetje nga shumë bartës të të drejtave, si dhe për rritjen e inkasimeve. Shpërndarja individuale praktike, bazuar në databazë, është dëshmia e funksionimit të mirëfilltë të SHAK-së.

CILËT JANË PËRDORUESIT DHE DETYRIMET E TYRE?

Përdoruesit janë persona fizikë ose juridikë, biznese që përdorin dhe shfrytëzojnë një veprë në çfarëdo mënyre të mundshme. Përdoruesit lidhin marrëveshje me shoqatat e administrimit kolektiv, në rast të një interpretimi publik të veprës. Kur vepra kreative e mbrojtur me të drejtë autori përdoret ose kopjohet pa lejen e bartësit të të drejtave, këtë e quajmë shkelje të së drejtës së autorit.

PO NËSE PËRDORUESIT DHE SHOQATAT E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV NUK BIEN DAKORD PËR TARIFAT?

Shoqatat kolektive dhe përfaqësuesit e përdoruesve mund të propozojnë, në bazë të marrëveshjes së ndërmjetësimit, ndërmjetësim në konteste në lidhje me dakordimin për përcaktimin e tarifave të përgjithshme. Palët bashkërisht zgjedhin ndërmjetësin nga lista e ndërmjetësuesve të emëruar nga Zyra e të Drejtave të Autorit dhe të Drejtave të Përafërta.

PARIMET E PËRGJITHSHME PËR TË PËRCAKTUAR NËSE TARIFA ËSHTË E ARSYESHME

Ekzistojnë dy forma themelore të tarifave:

Përqindja e të hyrave nga përdorimi i veprave ose lëndëve të tjera. Kjo vlen kryesisht për përdorime që lidhen me aktivitetet kryesore të përdoruesve, siç janë shfaqjet teatrale, koncertet, botimet.

Shuma fikse është tipike për përdorime që nuk i përkasin veprimtarisë primare të përdoruesve.

Për tarifatat e shprehura në përqindje, ekzistojnë standarde të pranuar ndërkombëtarisht (zakonisht rregulli 10%). Shumat fikse caktohen në bazë të faktorëve specifikë që dallojnë nga vendi në vend, por ka parime gjerësisht të pranuar të llogaritjes, përveç reprografisë dhe tarifave private të kopjimit.

MBIKËQYRJA E SHOQATAVE PËR ADMINISTRIM KOLEKTIV

Mbikëqyrja e shoqatave kolektive në Kosovë është një nga kompetencat e Zyrës së të Drejtave të Autorit dhe të Drejtave të Përafërta. Mbikëqyrja e shoqatave kolektive nënkupton kontrollin e SHAK-ve në fazën e krijimit si dhe në fazën e funksionimit. Kontrolli administrativ i veprimtarisë të SHAK-ve ka bazën në mbrojtjen e interesit të përgjithshëm.

Për qëllime të mbikëqyrjes së tillë, organizatat e menaxhimit kolektiv duhet t'i dorëzojnë Zyrës: statutet dhe rregulloret e tyre, si dhe çdo ndryshim/plotësim të tyre; kontratat e tyre bilaterale dhe multilaterale të lidhura me organizata të huaja të menaxhimit kolektiv; informacion mbi personat e autorizuar për përfaqësim; vendimet e organeve të tyre më të larta drejtuese (siç është Asambleja e Përgjithshme); raportin dhe bilancin e tyre vjetor; raportet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm të aktiviteteve të tyre; çdo dokument tjetër të domosdoshëm për të verifikuar pajtueshmërinë e veprimtarive të organizatave me këtë ligj dhe ligjet e tjera përkatëse të Republikës së Kosovës ose vetë statutet e tyre.

Zyra rishikon aktivitetet e organizatave të menaxhimit kolektiv një herë në vit. Sidoqoftë, Zyra mund të kryejë shqyrtim specifik midis dy rishikimeve të rregullta vjetore nëse merr informacion - nga anëtarët e organizatës, nga pronarë të tjerë të të drejtave, nga përdorues ose nga ndonjë burim tjetër relevant - në bazë të të cilave mund të lindin dyshime të arsyeshme mbi atë nëse veprimtaritë e organizatës janë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe ligjeve të tjera përkatëse të Republikës së Kosovës ose vetë statuteve të tyre.

Zyra përgatit raport të rezultateve të çdo shqyrtimi dhe organi më i lartë drejtues i organizatës së menaxhimit kolektiv (siç është Asambleja e Përgjithshme) obligohet të paraqesë brenda raportit të tij rendin e ditës për mbledhjen e tij të ardhshme, ta diskutojë këtë, si dhe ta informojë Zyrën për rezultatet e diskutimit dhe masat që mund të merren.

Kur Zyra konstaton se veprimtaritë e organizatës së menaxhimit kolektiv nuk janë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe ligjeve të tjera përkatëse të Republikës së Kosovës, ose të statuteve të saj, Zyra mund t'i kërkojë organizatës të sigurojë pajtueshmërinë e veprimtarisë së saj me ato dispozita, duke përcaktuar edhe afatin e arsyeshëm për këtë. Kur organizata nuk e përmbush këtë detyrim, Zyra, në varësi të rrethanave, mund të pezullojë ose revokojë akreditimin e dhënë për organizatën e menaxhimit kolektiv.

Në praktikë, bartësit e të drejtave nuk kanë ndonjë zgjedhje tjetër përveç se t'ia besojnë menaxhimin e të drejtave të tyre SHAK-ve. Nëse SHAK-të nuk veprojnë si duhet, të drejtat neglizhohen dhe kufizohen në praktikë. Është e arsyeshme të vendosen dispozita ligjore që sigurojnë funksionimin e duhur të SHAK-ve. Dispozitat e veçanta e kushtëzojnë krijimin e SHAK-ve me miratimin nga autoriteti kompetent.

Organizata mund të funksionojë si organizatë e menaxhimit kolektiv nëse regjistrohet si shoqatë, si dhe akreditohet si organizatë e menaxhimit kolektiv nga Zyra. Zyra i jep akreditimin organizatës për të funksionuar si organizatë e menaxhimit kolektiv nëse përmbush kërkesat e mëposhtme:

(a) anëtarësia e saj, ose rrethi i atyre pronarëve të të drejtave që ndryshe ia kanë besuar administrimin e të drejtave, shtrihet në një pjesë të konsiderueshme të pronarëve të të drejtave, si dhe çdo pronar i të drejtave në të njëjtën kategori mund të bashkohet me të në përputhje me rregulloret e saj;

(b) ka lidhur marrëveshje të përfaqësimit reciprok me organizata që përfaqësojnë pronarë të huaj të të drejtave në të njëjtën kategori, ose të paktën bën të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lidhur marrëveshje të tilla;

(c) ka aftësinë për të menaxhuar të drejtën ekonomike në fjalë, përfshirë stafin e duhur dhe pajisjet teknike;

(d) ka në dispozicion mekanizmat e duhur për mbledhjen, shpërndarjen dhe pagimin e honorareve;

(e) garanton trajtim të barabartë si për pronarët e të drejtave ashtu edhe për përdoruesit kur kushtet objektive të trajtimit janë të njëjta;

(f) veprimtaritë e saj nuk përfshijnë ndonjë qëllim komercial ose qëllime të tjera fitimprurëse;

(g) statuti i saj dhe rregulloret e tjera janë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe ligjeve të tjera relevante të Republikës së Kosovës.

SI TË SIGURONI RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TUAJA?

Teknologjitë digjitale e bëjnë të lehtë transmetimin dhe krijimin e kopjeve të përsosura të veprave dhe përmbajtjeve tjera të mbrojtura. Në rast të mosmarrëveshjeve me një përdorues të veprës suaj, si dhe nëse nuk ka mundësi për të zgjidhur mosmarrëveshjen në mënyrë miqësore, atëherë duhet të përmbaroni të drejtat tuaja dhe me ndihmën e avokatit të ndërmerrni disa veprime, duke përdorur procedurat e ekzekutimit.

Procedurat e përmbaramit mundësojnë veprim efektiv kundër shkeljes, mjete juridike të shpejta për të parandaluar shkeljen, parandalimin e shkeljeve të mëtejshme, si dhe nuk duhet të jenë të komplikuar dhe të kushtueshme pa arsye, ose me afate kohore që shkaktojnë vonesa të paarsyeshme.

Le të supozojmë në shembullin tonë se kënga juaj (mbi të cilat bartni të drejtën) përdoret pa autorizim për një reklamë, të themi të një jogurti, ndërsa reklama është e pahijshme. Ju ndiheni i fyer nga ky lloj përdorimi. Duhet të veproni me shpejtësi për të ndaluar shkeljen, ashtu që të ndaloni shkeljen dhe të shmangni ndonjë dëm të mëtejshëm.

Imagjinoni tani që keni rënë dakord me një kompani tjetër reklamimi për përdorimin e këngës suaj për një produkt tjetër, të themi një pije shumë popullore, konceptin e së cilës e keni aprovuar. Nëse nuk veproni me shpejtësi, është shumë e mundur që ky përdorim i aprovuar të mos ndodhë kurrë.

Paragrafët vijues përmbledhin disa nga dispozitat e ekzekutimit që gjenden në legjislacionin vendor të Kosovës. Këto mund të ndahen në kategoritë e mëposhtme: mjetet juridike civile; sanksione penale; masat kufitare; dhe masat, mjetet juridike dhe sanksionet kundër keqpërdorimeve në lidhje me pajisjet teknike.

MJETET JURIDIKE CIVILE PËRFSHIJNË:

- Dëshmitë: paraqitja e dëshmimeve nga pala kundërshtare
- Masat e përkohshme ndaj palës për të ndaluar shkeljen
- Vendimi për kompensim duhet të jetë adekuat për të kompensuar dëmet
- Largimi i mallrave kundërvajtëse nga kanalet komerciale
- Urdhrat që kundërvajtësit të informojnë për kanalet e shpërndarjes së mallrave kundërvajtës

Në shembullin tonë më lart, ju (pra bartësi i së drejtës) mund të kërkonti dëmshpërblim për dëmet e shkaktuara, ose edhe për të ndaluar përdorimin e veprës brenda reklamës.

MASAT E PËRKOHSHME DUHET TË JENË NË DISPOZICION:

- Për të parandaluar shkeljen, si dhe në veçanti, për të parandaluar hyrjen në kanalet e tregtisë të mallrave kundërvajtës
- Për të ruajtur provat përkatëse në lidhje me shkeljen e pretenduar Must be available
- Duhet të jenë të disponueshme inaudita altere parte kur është e përshtatshme, në veçanti kur vonesat kanë gjasë të shkaktojnë dëme të pariparueshme ndaj bartësit të së drejtës ose kur ekziston rreziku i qartë që provat e tilla të shkatërrohen.

Në shembullin tonë më lart, ju (pra bartësi i së drejtës) duhet të lëvizni shpejt, pa ndonjë vonesë, në mënyrë që kënga të ndalet nga përdorimi në reklamë, përndryshe mund të humbni marrëveshjen e bërë me kompaninë tjetër reklamuese. Për këtë arsye, do të ndiqni procedurën inaudita altere parte.

Përfituesit e sanksioneve dhe mjeteve juridike janë bartësit origjinalë të të drejtave të pronës intelektuale, të licencuarit dhe pasardhësit e titullit, shoqatat kolektive dhe organet profesionale të mbrojtjes.

Sanksionet penale kanë për qëllim të ndëshkojnë ata që kryejnë shkelje me peshë posaçërisht të rëndë, siç janë veprimet e qëllimshme të piraterisë, të kryera në përmasa komerciale, si dhe kështu të parandalojnë shkeljet e mëtejshme. Qëllimi i dënimit arrihet përmes gjobave dhe dënimeve me burg në përputhje me nivelin e ndëshkimeve që vendosen për krimet e peshës përkatëse, sidomos për recidivistët e veprave. Edhe parandalimi shërbehet kështu, si në procedurë civile, me urdhra për konfiskimin dhe shkatërrimin e mallrave kundërvajtës dhe të materialeve dhe pajisjeve të përdorura kryesisht për të kryer veprën penale.

Masat kufitare janë të ndryshme nga masat e ekzekutimit të përshkruara deri më tani, në kuptimin që kërkohen veprime nga autoritetet doganore. Masat kufitare i mundësojnë pronarëve të të drejtave të kërkojnë që autoritetet doganore të pezullojnë lëshimin në qarkullim të mallrave të dyshuar për shkelje të së drejtës së autorit. Kjo ka për qëllim t'u japë pronarëve të duhur kohë të arsyeshme për të filluar procedurat gjyqësore kundër shkelësit të dyshuar, pa rrezikun që mallrat që pretendohen të jenë kundërvajtëse të zhduken në qarkullim pas zhdoganimit. Zakonisht, pro-

narët e të drejtave duhet të plotësojnë disa kërkesa të tilla si: (a) të bindin autoritetet doganore që ka prova prima facie të shkeljes; (b) të ofrojnë përshkrim të hollësishëm të mallrave ashtu që të mund të dallohen; dhe (c) të ofrojnë sigurimin për dëmshpërblimin e importuesit, pronarit të mallrave dhe autoritetet doganore në rast se mallrat vlerësohen të mos jenë kundërvajtëse. Pas ndalimit të mallrave nga Dogana, bartësi i të drejtës zakonisht kërkon nga gjykata masa të përkohshme, për të penguar lëshimin e mallrave në treg, në pritje të një vendimi përfundimtar për akuzën e shkeljes.

Kategoria e fundit e dispozitave të ekzekutimit përfshin **masat, mjetet juridike dhe sanksionet ndaj keqpërdorimeve në lidhje me mjetet teknike, që quhen edhe masa mbrojtëse teknologjike (TPM)**, që kanë fituar në rëndësi që nga avancimi i teknologjive digjitale. Në raste të caktuara, mënyra e vetme praktike për të parandaluar kopjimin është përmes të ashtuquajturve sisteme të mbrojtjes së kopjimit ose menaxhimit të kopjimit. Këta përdorin pajisje teknike që ose pengojnë plotësisht kopjimin ose e bëjnë cilësinë e kopjeve aq të dobët sa të jenë të papërdorshme. Mjetet teknike përdoren edhe për të parandaluar pranimin e programeve televizive komerciale të koduara, përveç me përdorimin e dekoderëve. Sidoqoftë, teknikisht është e mundur të prodhohen pajisje që anashkalojnë sisteme të tilla të mbrojtjes ndaj kopjimit dhe të kodimit. Këto dispozita të ekzekutimit kanë për qëllim të parandalojnë prodhimin, importimin

dhe shpërndarjen e pajisjeve të tilla. Traktati i WIPO-së (WCT) përmban dispozita për këtë qëllim, si dhe dispozita për të parandaluar heqjen ose ndryshimin e paautorizuar të **informacionit të menaxhimit** elektronik të të drejtave dhe shpërndarjen e kopjeve të veprave nga të cilat është hequr informacioni i tillë. Informacioni për menaxhimin e të drejtave mund të identifikojë autorin ose pronarin e duhur, ose të përmbajë të dhëna në lidhje me afatet dhe kushtet e përdorimit të veprës. Largimi i informacionit kështu mund të pengojë në zbulimin e shkeljeve ose të rezultojë me shtrembërimin e sistemeve të menaxhimit kompjuterik të të drejtave ose të shpërndarjes së tarifave. Ligjet vendore mund të përmbajnë edhe përjashtime nga zbatimi i këtyre masave në rrethana të caktuara, si ato që rrisin efektshmërinë e kufizimeve dhe përjashtimeve të së drejtës së autorit të parashikuara në ligjin vendor.

PROVONI NJOHURITË TUAJA MBI TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA

E drejta e autorit është ligj që:

- a) rregullon mbrojtjen e shpikjeve
- b) rregullon mbrojtjen e autorit
- c) rregullon të drejtat e kompanive mbi investimet e tyre

Ligji për të drejtat e autorit mbron:

- a) idetë që janë baza e një vepre
- b) veprat origjinale të shprehura në çdo formë
- c) çfarë na thotë Arti që është e denjë për t'u mbrojtur

Skulptura në akull:

- a) nuk mund të mbrohet edhe nëse është origjinale sepse shkrihet
- b) mbrohet me kushtin që të jetë origjinale

Vepra gojore:

- a) nuk mund të mbrohet nga e drejta e autorit edhe nëse është origjinale, sepse nuk është e trupëzuar në një bartës fizik
- b) mbrohet me të drejtën e autorit nëse është origjinale

Sipas Ligjit vendor për të Drejtat e Autorit, mbrohen llojet e mëposhtme të veprave:

- a) Veprat letrare dhe shkencore (literaturë, poezi, libra shkollorë, artikuj, tekste këngësh, programe kompjuterike, etj)
- b) vepra të arteve të bukura (pikturë, skulpturë, fotografi, vizatime, harta, karikatura, arkitektura etj.)
- c) Veprat muzikore (partitura, kolona zanore etj)
- d) vepra dramatike (skenarë, vepra teatrale etj)
- e) të gjitha këto

Nuk konsiderohet vepër:

- a) lajmet dhe informacionet e mediave të raportimit të rregullt
- b) opera
- c) punimet arkitektonike

Sipas mendimit mbizotërues në doktrinën dhe jurisprudencën në Shtetet Anëtare të BE-së, recetat e gatimit:

- a) janë të mbrojtura me të drejtë autori nëse janë origjinale
- b) nuk mund të mbrohen me të drejtë autori sepse janë njohuri teknike

Prezantimi i një pjate:

- a) mbrohet me të drejtën e autorit nëse është origjinale
- b) nuk mund të mbrohet me të drejtë autori sepse qëllimi i saj është të konsumohet.



Histori e vërtetë: Një majmun vjedh kamerën e një fotografi dhe fillon të bëjë vetë foto; në fakt, ai bëri selfie. Fotografia është e bukur dhe është publikuar në Internet.

Bartësi i të drejtës së autorit mbi foton është:

- a) majmuni
- b) fotografi, sepse është aparati i tij fotografik
- c) Askush. Fotografia nuk mbrohet edhe nëse është origjinale, sepse vetëm personat fizikë (dhe jo kafshët apo robotët) mund të jenë autorë.

Të drejtat e autorit vlejné:

- a) për tërë jetën e autorit; pastaj, hyjnë në domenin publik
- b) nga momenti i krijimit të veprës dhe 50 vjet pas vdekjes së autorit
- c) nga momenti i krijimit të veprës dhe 50 vjet pas vdekjes së autorit

Cila nga të drejtat e mëposhtme nuk është pjesë e të drejtave ekonomike të autorit, por e të drejtave të tij morale:

- a) e drejta e riprodhimit
- b) e drejta e komunikimit publik
- c) të drejtat e integritetit
- d) e drejta e shpërndarjes

Nëse e keni botuar veprën që keni krijuar në faqen tuaj të internetit:

- a) secili mund ta përdorë veprën për çfarëdo arsye, sepse duke e ngarkuar në internet, keni hequr dorë nga të drejtat tuaja përgjithmonë
- b) secili mund ta përdorë veprën. Ngarkimi në Internet nuk do të thotë që keni hequr dorë nga të drejtat
- c) atëherë ajo bie në domenin publik, kështu që pushon së mbrojturi

E saktë apo e pasaktë?


	Saktë	Pasaktë
Autori është i detyruar t'i referohet emrit të tij		
Autori nuk mund të përdorë pseudonim		
Vepra mund të jetë anonime		
Kopjimi privat lejohet vetëm nëse kopja është bërë për përdorim personal.		


Përgjashtimi nga e drejta e autorit

- a) mohon çdo të drejtë autori
- b) mundëson përdorimin e veprës vetëm nëse bartësi i të drejtës ju autorizon
- c) lejon përdorimin e veprës pa autorizim

Vepra muzikore ka gjasë të mbrohet:

- a) vetëm me të drejtë autori
- b) nuk ka të drejta për veprat muzikore
- c) me të drejtë autori dhe të drejta të përafërta të interpretuesve dhe prodhuesve të fonogrameve





Kjo broshurë është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e kësaj broshure është përgjegjësi e vetme e IBF International Consulting dhe EPLD dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

© IPR Project Kosovo
Dhjetor, 2020
Prishtinë, Kosovë

IPRproject

Intellectual Property Rights Project

Rr. "Johan V. Hahn",
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: 038 726 688

 IPRKosovo